



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Korrik — Dhjetor 2019

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....4

AKTGJYKIME9

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME13

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata aktualisht përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë vendor.






Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 31 dhjetor 2019, Gjykata ka pranuar 134 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 309 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 111 kërkesa janë zgjidhur ose 35.9% e të gjitha rasteve në disponim.

Gjatë kësaj periudhe, 111 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve
(1 korrik – 31 dhjetor 2019)*



Në vijim janë paraqitur 8 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 korrik – 31 dhjetor 2019:

- Aktgjykim në rastin KI 25/18, parashtruar nga: Vasilje Antović. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 24 prillit 2017.
- Aktgjykim në rastin KI 24/17, parashtruar nga: Bedri Salihu. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017.
- Aktgjykim në rastin KO 58/19, parashtruar nga: Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 145/18, parashtruar nga: Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë

Ibrahimi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018.

- Aktgjykim në rastin KO 65/19, parashtruar nga: Avokati i Popullit. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë.

- Aktgjykim në rastin KI 128/17, parashtruar nga: Naser Husaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017, të 23 gushtit 2017.

- Aktgjykim në rastin KI87/18 dhe KI11/19, parashtruar nga: Muhamet Idrizi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018.

- Aktgjykim në rastin KI 10/18, parashtruar nga: Fahri Deqani. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017.


Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 134 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 korrik – 31 dhjetor 2019, janë si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 3 raste ose 2,2%;
- Neni 23 [Dinjiteti i njeriut], 2 raste ose 1,5 %;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 49 raste ose 36,6 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 48 raste ose 35,8 %;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 3 raste ose 2,2%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 9 raste ose 6,7%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 4 raste ose 3 %;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 2 raste ose 1,5%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të institucioneve shtetërore, 1 rast ose 0,7%;

- Shkelje të tjera, 13 raste ose 9,7%;


*Shkeljet e pretenduara, sipas llojit të shkeljeve
(1 korrik – 31 dhjetor 2019)*



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 124 kërkesa ose 92,5% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 10 kërkesa ose 7,5% të kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

*Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 korrik – 31 dhjetor 2019)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 107 kërkesa nga shqiptarët, ose 79,9%;
- 4 kërkesa nga komuniteti serb, ose 3%;
- 2 kërkesa nga komunitetet e tjera, ose 1,5%;
- 21 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridik) ose 15,7 %;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 korrik – 31 dhjetor 2019)*




Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2019, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 18 seanca plenare dhe 102 kolegje shqyrtuese, në të cilat, rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 111 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 8 Aktgjykime (7,2%);
- 94 Aktvendime për papranueshmëri (84,7%);
- 4 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (3,6%);
- 2 Vendime për heqjen e kërkesës nga lista (1,8 %);
- 3 Vendime për masë të përkohshme (2,7 %);

*Struktura e vendimeve
(1 korrik – 31 dhjetor 2019)*



9 korrik 2019



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: “Standardet Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi Kriteret e Pranueshmërisë”, e cila u mbajt në “Hotel Emerald”, në Prishtinë.

E drejta e individëve për të parashtruar kërkesë në gjykatat kushtetuese, papranueshmëria e kërkesave në lidhje me juridiksionin e gjykatës dhe kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të zbatuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në këtë punëtori.

Folës kryesor në punëtorinë e mbajtur ishin: z. Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Manuela Brillat, profesoreshë e të drejtave të njeriut në Universitetin e Strasburgut dhe znj. Heidi Lempio, ish-zyrtare e EULEX-it për të drejta të njeriut dhe çështje juridike.

Punëtorja e mbajtur shënoi aktivitetin e radhës në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun.

24 korrik 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim lamtumirës ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, z. Per Strand Sjaastad.

Pasi që i shprehu falënderimin për kontributin që Mbretëria e Norvegjisë i ka dhënë Republikës së Kosovës veçanërisht në avancimin e sundimit të ligjit në vend, kryetarja Rama-Hajrizi e falënderoi ambasadorin Sjaastad edhe për ndihmën e ofruar nga qeveria norvegjeze në ngritjen e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Me këtë rast ajo vuri theksin në rëndësinë e projektit të iniciuar në fillim të këtij viti, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe të ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun. Kryetarja Rama-Hajrizi vlerësoi se ky projekt do të forcojë edhe

edhe më shumë zbatimin e kushtetutshmërisë dhe do të mundësojë përafrimin më të shpejt të vendit tonë me standardet evropiane të drejtësisë kushtetuese.

Në fund, ajo e falënderoi ambasadorin Sjaastad për angazhimin e tij dhe për përkrahjen e ofruar Gjykatës Kushtetuese gjatë shërbimit në Kosovë, duke i uruar suksese të mëtutjeshme në karrierë.



Pasi që e falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen dhe për bashkëpunimin e deritanishëm, ambasadori Sjaastad shprehu bindjen se përkrahja e Norvegjisë për Gjykatën Kushtetuese, por edhe për institucionet e tjera shtetërore të Kosovës, nuk do të mungojë as në të ardhmen.

6 shtator 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim njohës ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott. Pasi që i uroi suksese në detyrën e tij të re, kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi ambasadorin

Abbott me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, me sfidat e përballura pas largimit të njëkohshëm të katër gjyqtarëve, dy prej tyre ndërkombëtarë, si dhe me kontributin e këtij institucioni në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Gjatë bashkëbisedimit, ajo vuri theksin edhe në raportet e mira të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit dhe ato evropiane, si dhe në përpjekjet e vazhdueshme që po bëhen për rritjen e transparencës në punë dhe në avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës.

Kryetarja Rama-Hajrizi e falënderoi ambasadorin Abbott për ndihmën që Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i ka ofruar deri më tani Gjykatës Kushtetuese, por edhe institucioneve të tjera në vend, në mbështetje të zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ambasadori Abbott e falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen dhe konfirmoi që për Mbretërinë e Bashkuar prioritet ka qenë dhe mbetet sundimi i ligjit në Kosovë, për të cilën do të vazhdojë mbështetja.

20 shtator 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim njohës ambasadorin e ri të Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, z. Jens Erik Grøndahl.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetarja Rama-Hajrizi fillimisht i uroi ambasadorit Grøndahl suksese në detyrën e tij të re, për ta njoftuar më pas atë përkitazi me përbërjen, me rolin, si dhe me sfidat e përballura deri më tani në zhvillimin institucional të Gjykatës Kushtetuese.

Në vazhdim të takimit, ajo foli edhe rreth përpjekjeve të vazhdueshme që po bëhen për anëtarësimin e Gjykatës Kushtetuese në organizatat dhe forumet e ndryshme ndërkombëtare, si dhe për konsolidimin e vendimmarrjes profesionale të Gjykatës.

Kryetarja Rama-Hajrizi shfrytëzoi rastin që të shpreh edhe falënderimin e saj për ambasadën e Norvegjisë në Kosovë, për mbështetjen e ofruar projektit që synon zbatimin më efektiv nga Gjykata Kushtetuese të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun, të iniciuar gjatë muajit mars në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Ambasadori Grøndahl konfirmoi se, Norvegjia edhe më tutje do të vazhdojë të përkrah Gjykatën Kushtetuese dhe institucionet e Kosovës, duke e vlerësuar si parësore progresin e mëtijshëm në sundimin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

27 shtator 2019



Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në krye me kryetaren e Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi, qëndroi për vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Italisë, me seli në Romë. Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u prit në takim nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, z. Giorgio Lattanzi, dhe dy zëvendëskryetarët e kësaj gjykate, znj. Marta Cartabia dhe z. Mario R. Morelli. Gjatë bashkëbisedimit, të dyja palët shkëmbyen përvojat dhe pikëpamjet e tyre përkitazi me sistemet respektive gjyqësore të të dyja vendeve, duke pasur në fokus veçanërisht pavarësinë funksionale të gjykatave kushtetuese, procesin e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, si dhe reformat ligjore në sistemin e drejtësisë. Kontrolli kushtetues i akteve të autoriteteve qendrore, shqyrtimi i vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe thellimi i bashkëpunimit në fushat me interes reciprok, ishin gjithashtu temë e diskutimit në takim. Gjyqtarët e të dy gjykatave në vazhdim morën pjesë në një punëtori të përbashkët, ku ndër temat e trajtuara ishte edhe roli i gjykatave kushtetuese në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

23 tetor 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kremtoi jubileun e Vitit të 10-të Gjyqësor me një ceremoni solemne që u mbajt në Hotel "Emerald", në Prishtinë. Hapja e ceremonisë jubilarë u bë me një fjalim rasti nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, në të cilën pjesëmarrës ishin

personalitetet më të larta shtetërore e ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë nga gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit dhe të vendeve të tjera evropiane.



Me fjalim rasti, pjesëmarrësve në ceremoninë solemne iu drejtuan edhe juristja me nam ndërkombëtar dhe njëherësh përfaqësuesja e Republikës së Irlandës në Komisionin e Venecias, znj. Grainne McMorro, si dhe ish-gjyqtarja ndërkombëtare e Gjykatës Kushtetuese, Prof. dr. Snezhana Botusharova.

24 tetor 2019

Me rastin e shënimit të Vitit të 10-të Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në hotelin “Emerald” në Prishtinë u mbajt Konferenca ndërkombëtare në temën: *“Sigurimi i sundimit të ligjit dhe i të drejtave të njeriut përmes mekanizmave të drejtësisë kushtetuese: Sfidat e shekullit 21”*.



Konferencën e shpalli të hapur kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, e cila gjatë diskutimit të saj, ndër të tjera tha se, “sundimi i ligjit është parakusht i padiskutueshëm për mbrojtjen e vlerave kushtetuese mbi të cilat është themeluar dhe ndërtuar Republika e Kosovës, dhe mbi të cilat kjo e fundit duhet të përforcohet dhe zhvillohet në dekadat që do të pasojnë”. Sipas kryetares Rama-Hajrizi, “sfidat e shekullit 21, me të cilat ballafaqohen gjykatat që mbartin përgjegjësinë e vendosjes përfundimtare të drejtësisë kushtetuese, janë sfida me të cilat nuk janë përballur më parë dhe paraqesin risi në mënyrën se si ndërlidhen të drejtat e njeriut me sundimin e ligjit”.

Në vazhdim të konferencës me prezantimet e tyre u paraqitën: z. Jean-Claude Wiwinius, kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Luksemburgut, z. Bekim Sejdiu, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Enver Peci, kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, si dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese të Malit të Zi, të Republikës Çeke, të Maqedonisë së Veriut, të Portugalisë dhe të Turqisë.

8 nëntor 2019



Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP), Gjykata Kushtetuese prezantoi për studentët e nivelit bachelor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, veçorinë kryesore hulumtuese të ueb-faqes së saj të re.

Gjatë prezantimit të mbajtur në amfiteatrin e Fakultetit Juridik, studentët patën rastin që të informohen më për së afërmi me karakteristikat dhe me mundësitë e kërkimit të avancuar të vendimeve të Gjykatës, duke shfrytëzuar filtrimin e bazuar në llojin e kërkesës, numrin e lëndës, emrin e parashtruesit, datën e parashtrimit apo fjalët kyçe të përmbajtjes së vendimeve.

Mundësia e abonimit të drejtpërdrejtë në vendimet e fundit të publikuara, si dhe në buletinët e praktikës gjyqësore dhe buletinët informativë periodikë të Gjykatës, ishin një veçori tjetër e ueb-faqes me të cilën u njohën më në detaje studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Prezantimi i ueb-faqes së Gjykatës Kushtetuese u bë nga Drejtori i Zyrës për Informim dhe Komunikim të Gjykatës, z. Veton Dula, si dhe këshilltari i lartë kushtetues – juridik i Gjykatës, z. Jeton Bytyqi.

12 nëntor 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim njohës ambasadorin e re të Francës në Kosovë, znj. Marie-Christine Butel.

Pasi që i uroj suksese në detyrën e re, kryetarja Rama-Hajrizi e informoi ambasadorin Butel me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese dhe me progresin e arritur në konsolidimin e gjyqësisë kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Zhvillimet aktuale në vend, sfidat në përpjekjet për forcimin e sundimit të ligjit dhe iniciativat për reforma ligjore e kushtetuese, ishin gjithashtu temë e

diskutimit të përbashkët. Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim të takimit shprehu falënderimin e saj për kontributin e vazhdueshëm që Qeveria franceze u ka ofruar institucioneve të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të saj, nëpërmjet projekteve që për qëllim primar kishin avancimin e kapaciteteve profesionale e infrastrukture, si dhe zhvillimin ekonomik në vend.



Ambasadorja Butel, pasi që e falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen, rikonfirmoi gatishmërinë e Francës që të mbështesë edhe më tutje përpjekjet e Gjykatës Kushtetuese dhe të institucioneve të tjera në zbatimin e standardeve evropiane të drejtësisë.

19 nëntor 2019



Me ndërmjetësimin e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP) dhe të Shoqërisë Federale Amerikane për Studime të Ligjit dhe të Politikave Publike, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës mbajtën një diskutim profesional nëpërmjet video-konferencës, me kryetarin e Gjykatës së Qarkut të Minesotas në SHBA, z. John R. Tunheim. Shkëmbimi i përvojave reciproke rreth procedurave të zhvilluara në seancat shqyrtuese dhe roli i gjyqtarëve në drejtimin e seancave publike ishin ndër temat kryesore të trajtuara në këtë

video-konferencë. Në vazhdim të diskutimit, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u njohën më për së afërmi edhe me praktikën e gjykatave federale të Shteteve të Bashkuara.

22 nëntor 2019



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan tryezën e rrumbullakët në temën: *“Parimet dhe Metodologjia e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, e cila u mbajt të enjten dhe të premten, më 21 dhe 22 nëntor 2019, në Hotel “Garden” në Prishtinë. Procedimi i rasteve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), metodat administrative të GJEDNJ-së, subsidiariteti dhe aplikimi i metodave të GJEDNJ-së nga gjykatat kombëtare, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në këtë tryezë me gjyqtarë dhe këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese.

Panelistë dhe moderator të tryezës ishin: Dr. Kanstantsin Dzehtsiarou, ligjërues i së drejtës në katedrën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Liverpulit në Angli dhe z. Velimir Delovski, ekspert i të drejtave të njeriut nga Republika e Maqedonisë.


Tryeza e rrumbullakët u organizua në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun.

5 dhjetor 2019

Gjyqtarët dhe këshilltarët kushtetues-juridikë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në Konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë në temën: *“Liria e shprehjes dhe jurisprudenca kushtetuese në Ballkanin Perëndimor”*, që u mbajt në “Hotel Swiss Diamond” në Prishtinë.

Në fjalën e saj hapëse, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, ndër të tjera tha se, *“Gjykata Kushtetuese e Kosovës asnjëherë nuk e ka kufizuar veten duke u mbështetur në interpretimin vetëm të dispozitave të Kushtetutës së vendit kur është fjala për respektimin e lirisë së shprehjes”*. Sipas saj, në mbrojtje të kësaj të drejte themelore të njeriut, *“Gjykata Kushtetuese gjithmonë ka marrë parasysh dhe ka bërë krahasimin me praktikën e konsoliduara të gjykatave kushtetuese*

evropiane, dhe çdoherë ka aplikuar me besnikëri nënën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).



Në mesin e folësve kryesor në konferencë, që për qëllim pati edhe diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave të gjykatave kushtetuese të rajonit në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishte edhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Remzije Istrefi-Peci, e cila mbajti një prezantim në çështjen e lirisë së shprehjes për gjyqtarët sipas praktikës së GJEDNJ-së, z. Naser Ajdari, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, znj. Mirjana Lazarova, ish-gjyqtare në GJEDNJ, znj. Beth Grossman, avokate në Britaninë e Madhe, z. Paolo Cavalieri, profesor i së drejtës së mediave në Universitetin e Edinburgut, znj. Fatma Gülbin Üzcüre, këshilltare e lartë ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Turqisë dhe znj. Sevima Sali Terziq, këshilltare e lartë ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës.

Në vijim të konferencës u shfaq edhe video-animacioni i realizuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, përkritazi me të drejtën dhe mënyrat e parashtrimi të kërkesave nga individët dhe palët e tjera të autorizuar në Gjykatën Kushtetuese.

20 dhjetor 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, mori pjesë në takimin vjetor të Forumit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës, i cili këtë vit u organizua në "Hotel Emerald" në Prishtinë, me përkrahjen e ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë. Në fjalimin e mbajtur para përfaqësuesve të

prokurorisë dhe gjyqësorit të rregullt, si dhe diplomatëve të akredituar në vend, kryetarja Rama-Hajrizi, kryesisht diskutoi mbi mundësitë që prokurorët dhe gjykatat e rregullta i kanë në dispozicion për të shmangur shkeljen e të drejtave të njeriut dhe rrjedhimisht uljen e numrit të ankesave të individëve me pretendimet për shkelje të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese.

Ndër të tjera, kryetarja Rama-Hajrizi tha se, "ndonëse Kushtetuta e ka caktuar Gjykatën Kushtetuese si autoritetin përfundimtar për interpretimin final të Kushtetutës, autoritetet e tjera publike, përfshirë prokurorinë dhe gjyqësorin e rregullt, janë padyshim në linjën e parë të mbrojtjes së Kushtetutës".

Sipas saj, "Gjykata Kushtetuese i shpall si të papranueshme mbi 90 për qind të kërkesave të parashtruesve, ku kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së një vendimi të gjykatave të rregullta. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese konfirmon kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta në mbi 90 për qind të rasteve".

Në përmbyllje të fjalës, kryetarja Rama-Hajrizi pohoi se, arsyetimi i gjerë i aktakuzës dhe mbështetja e saj me prova e dëshmi nga prokuroria, si dhe arsyetimi i bazuar i vendimeve gjyqësore në raport me pretendimet ankimore të palëve, paraqesin garancën më të sigurt për evitimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut në një proces gjyqësor.



Aktgjykim

KO 65/19

Parashtrues

Avokati i Popullit

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2018

Parashtruesi i kërkesës kontestoi nenet 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar, duke theksuar që nenet e cekura janë në shkelje të nenit 5 [Gjuhët] dhe paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Për sa i përket nenit 32 (1), parashtruesi i kërkesës pretendoi se neni në fjalë është në kundërshtim me nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës sepse lejon lëshimin e dokumenteve edhe në gjuhët tjera që nuk janë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Për sa i përket nenit 41 (1.3) dhe (1.4), parashtruesi i kërkesës pretendoi se neni në fjalë është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] sepse kërkon nga noterët që disa shërbime t'i kryejnë pa pagesë.

Për sa i përket nenit 76 (2), parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, pretendoi se neni në fjalë me veprim retroaktiv ka ndryshuar moshën e pensionimit të noterëve nga mosha 70 vjeç në 65 vjeç, me ç'rast atyre u janë mohuar pritjet legjitime dhe fitimi i ardhshëm çka ka rezultuar me shkelje të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata, në bazë të analizës së saj, konkludoi:

i) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 32 i ligjit të kontestuar shkelë nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse shërbimit noterial nuk i vendosen

drejtpërdrejt detyrime të reja, porse ato paraqiten ekskluzivisht si "mundësi" dhe se zbatimi dhe realizimi i tyre do të varet nga secili ushtrues i funksioneve noteriale individualisht. Gjykata konkludoi që neni 32 i ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim dhe nuk shkelë të drejtat nga neni 5 [Gjuhët] i Kushtetutës.

ii) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar janë në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse ligjvënësi, duke ndjekur trendët bashkëkohorë në një shoqëri demokratike, dhe me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të të drejtave pronësore të të dy gjinive, me zgjidhjet ligjore në nenin 41 (1.3) dhe (1.4) kanë paraparë saktësisht masën në të cilën ushtruesit e funksioneve të noterit duhet të kryejnë disa punë të caktuara juridike pa kompensim monetar. Gjykata konkludoi që paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim dhe nuk i shkelin të drejtat nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës.

iii) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3), të ligjit të kontestuar janë në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse, mes tjerash, "pritjet legjitime", vetvetiu, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk ofrojnë garanci që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional. Gjykata konkludoi se neni 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim dhe nuk i shkelin të drejtat nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së.

iv) në fund, Gjykata shpjegoi se ligjvënësi – për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik – është në pozitë më të mirë se sa ajo për të përcaktuar dhe avancuar politikën e ekonomike dhe sociale të vendit.

v) gjithashtu, Gjykata, duke pasur parasysh konkluzionet e veta në lidhje me nenin 76 (paragrafi 2), nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar, konkludoi që nuk ka bazë ligjore për vazhdim të mëtejme të masës së përkohshme, e cila ishte caktuar më 20 maj 2019, dhe ishte vazhduar më 20 maj 2019.



Aktgjykim

KO 58/19

Parashtrues

Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019

Kërkesa ishte parashtruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 113, paragrafi 2 nënparagrafi 1 i Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të KQZ-së të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

1. Vendimi nr. 57/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Qemajl Kurtishi, si anëtar i KQZ-së nga komuniteti boshnjak;
2. Vendimi nr. 58/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Stevan Veselinoviq, si anëtar i KQZ-së nga komuniteti serb;
3. Vendimi nr. 59/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Ercan Špat, si anëtar i KQZ-së nga komuniteti turk;
4. Vendimi nr. 60/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Alfred Kinolli, si anëtar i KQZ-së, si përfaqësues i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian;
5. Vendimi nr. 61/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e znj. Nazlie Bala, si anëtare e KQZ-së;
6. Vendimi nr. 62/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Adnan Rrustemi, si anëtar i KQZ-së;
7. Vendimi nr. 63/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Florian Dushi, si anëtar i KQZ-së;
8. Vendimi nr. 65/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Sami Hamiti, si anëtar i KQZ-së.

Parashtruesit e kërkesës pretendonin që vendimet e lartpërmendura nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesit e kërkesës në thelb para Gjykatës kishin këto pretendime kryesore:

Kundërshtimi i parë kishte të bënte me formën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Parashtruesit konsideronin nevojën e vënies së theksit tek terminologjia që ka përdorur Kushtetuta e Kosovës në dispozitën përkatëse nga neni 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, ku theksohet si në vijim: *“Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend”*. Pra, parashtruesit e kërkesës pretendonin që termi *“të përfaqësuara”* ka karakter *post festum*, që në vete nënkupton që, *“jo domosdoshmërisht subjekti politik që ka fituar mandate të caktuara në Kuvend do të jetë përfaqësuar në nivel të grupit parlamentar me po aq deputetë të mandatuar”*.

Gjithashtu, ata pretendonin që është dispozita e nenit 70, paragrafi 1 të Kushtetutës e cila i jep lirinë e ushtrimit të funksionit të deputetit brenda mandatit të tij duke mos iu nënshtruar asnjë mandati tjetër të detyrueshëm. Sipas parashtruesve të kërkesës, *“emërimi i anëtarëve të KQZ-së duke marrë parasysh strukturën e grupeve parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të subjekteve politike, do të konservonte lirinë politike të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës dhe do të mohonte iniciativat politike në formën e grupeve parlamentare të deputetëve”*.

Parashtruesit pretendonin se, Presidenti, duke interpretuar *“grupet më të mëdha parlamentare”* si partia, koalicioni, iniciativa qytetare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe duke emëruar anëtarët e KQZ-së, përmes akteve të kontestuara, sipas këtij interpretimi, ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese. Kjo, pasi sipas parashtruesve, *“grupet më të mëdha parlamentare”* sipas nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, janë grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat ekzistojnë si të tilla në momentin që Presidenti emëron anëtarët e KQZ-së.

Gjykata vlerësoi se kërkesa e parashtruesve është e pranueshme në bazë të kriterëve të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.



Në shtjellimin e meritave të kërkesës, Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Në lidhje me këtë, Gjykata konstatoi se vendimet e kontestuara, plotësojnë kushtet për të qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata në bazë të nenit 113, paragrafi 2, nënparagrafi 1 të Kushtetutës. Kjo pasi, Gjykata vlerësoi se vendimet e kontestuara, pavarësisht emërimit të tyre, janë të një natyre të detyrueshme dhe kanë të bëjnë me caktimin e anëtarëve të KQZ-së që është një institucion i pavarur kushtetues i mandatuar për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve në Kosovë, në bazë të autorizimeve të dhëna në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Zgjedhjet).

Gjykata rikujtoi fillimisht se Kushtetuta, përveç që përcakton mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dhe nga cilat grupe parlamentare emërohen, ajo nuk përmban ndonjë definicion specifik në lidhje me atë nëse grupet parlamentare për qëllim të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, janë grupet parlamentare: i) që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, apo, ii) ato që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me këtë, Gjykata vlerësoi dispozitat kushtetuese dhe dispozitat e tjera të ndërlidhura në lidhje me grupet parlamentare të Kuvendit duke marrë për bazë (i) rolin kushtetues të KQZ-së si institucion i pavarur për administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve; (ii) mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së; (iii) kohëzgjatjen e mandatit dhe (iv) kohën e emërimit të tyre.

Gjykata rikujtoi se anëtarët e KQZ-së nuk kanë mandat të caktuar kohor. Mandati i tyre është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim, fillon jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, përveç përjashtimeve të parapara në nenin 61, paragrafi 3

nënparagrafin (e), të Ligjit për Zgjedhjet. Andaj, sipas dispozitave të lartcekura, zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së nuk është e lidhur me çështjen e konstituimit të Kuvendit, që mund të bëhet apo jo brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore, as me grupet parlamentare në kuptimin e ngushtë të fjalës, që formohen pas konstituimit të Kuvendit, kur edhe fillon jeta parlamentare në kuptimin e plotë të fjalës, që mundëson organizimin e deputetëve në grupe parlamentare që mund të dallojnë nga partitë apo koalicionet që kanë dalë prej zgjedhjeve.

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, siguron që në KQZ të mos ketë vakum institucional pavarësisht kohës së konstituimit të Kuvendit. Kjo nënkupton që Presidenti, bazuar në nenin 61.4 të Ligjit të Zgjedhjeve, të mund të ushtrojë përgjegjësitë e tij për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas certifikimit të zgjedhjeve, sipas grupeve parlamentare/subjekteve politike, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve për Kuvend.

Andaj, Gjykata konstatoi se grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, për qëllim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës konsiderohen 6 (gjashtë) partitë, koalicionet, iniciativat qytetare, që kanë më shumë vende në Kuvend, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciativë qytetare që kanë marrë pjesë si të tilla në zgjedhjet për Kuvend.

Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se aktet e kontestuara nuk cenojnë dispozitat e Kushtetutës, përkatësisht, paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës.



Aktgjykim

KI 10/18

Parashtruesi

Fahri Deqani

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017

Parashtruesi i kërkesës, pas arrestimit të tij më 31 korrik 2010, ishte vendosur në paraburgim. Paraburgimi i tij në pritje të gjykimit kishte zgjatur deri më 3 shtator 2012, kur Gjykata e Qarkut kishte nxjerrë vendimin, me të cilin ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe duke e kthyer çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Gjatë periudhës ndërmjet 3 shtatorit 2012 dhe 26 nëntorit 2013, paraburgimi i parashtruesit ishte paraburgim pas aktgjykimit dënues në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 367 [Paraburgimi pas shpalljes së Aktgjykimit], paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Përderisa, si rezultat i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin rasti ndaj parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim, periudha e dytë e paraburgimit në pritje të gjykimit në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), kishte filluar më 26 nëntor 2013 dhe ka vazhduar deri me datën e nxjerrjes së aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], të 6 prillit 2018, me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim efektiv.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimet e gjykatave të rregullta për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës, respektivisht vendimi i

kontestuar i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri], paragrafi 4, dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, i konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar nuk justifikon vendimin e saj për vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Së këndejmi, gjykatat e rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse masat alternative nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme [Pml. nr. 357/2017], i 22 dhjetorit 2017, me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [PN1. nr. 2156/2017], të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR. nr. 155/15], të 24 nëntorit 2017, nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së.

Gjykata kishte parasysh faktin se, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim efektiv përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR. nr. 155/15], të 6 prillit 2018, në kuadër të procedurës penale të zhvilluar kundër tij. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujtoi që, kjo procedurë nuk ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata dhe se objekt i shqyrtimit ishte vetëm vlerësimi i aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme përkitazi me procedurën e vazhdimin të paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

Në këtë kontekst, Gjykata përmes këtij aktgjykimi përçoi në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë kërkesën dhe udhëzimin që duhet t'i u shërbejë gjykatave të rregullta se, për të qenë në përputhje me kërkesat kushtetuese të nenit 29 të Kushtetutës, dhe po ashtu edhe me kërkesat e nenit 5 të KEDNJ-së, siç është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, arsyetimet e tyre për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit duhet të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe vlerësim të individualizuar në pajtueshmëri me rrethanat dhe faktet e rastit, ku shpjegohet dhe dëshmohet se pse paraburgimi në pritje të gjykimit është i domosdoshëm, dhe se pse masat tjera alternative nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e papenguar dhe të suksesshëm të procedurës penale.

Gjykata, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kohëzgjatjen e masës së paraburgimit në pritje të dënimit të tij konstatoi se, nuk bien në kuadër të fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 korrik – 31 dhjetor 2019)

*** Dënimi penal i Selahattin Demirtaş për deklaratat e bëra gjatë një transmetimi televiziv kishte shkelur lirinë e tij të shprehjes (09/07/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Selahattin Demirtaş kundër Turqisë** (nr. 3) (*kërkesa nr. 8732/11*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, **njëzëri**, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (Liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dënimin penal të z. Demirtaş për deklaratat e bëra gjatë një transmetimi televiziv. Deklaratat e z. Demirtaş në thelb kishin nxitur autoritetet dhe publikun që të shqyrtojnë rolin potencial të z. Öcalan, udhëheqësit të burgosur të PKK-së (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit, një organizatë ilegale e armatosur), për të gjetur një zgjidhje paqësore për problemin kurd, dhe kishte bërë thirrje për përmirësim të kushteve të ndalimit të tij. Pas një shqyrtimi të hollësishëm të deklaratave në fjalë, Gjykata konstatoi se, marrë në tërësi, ata nuk mund të konsideroheshin si nxitje për t'u përfshirë në dhunë, rezistencë të armatosur ose rebelim, dhe as nuk përbënin gjuhë të urrejtjes.

Gjykata vendosi që procedurat penale të ngritura kundër parashtruesit të kërkesës nën akuzën e shpërndarjes së propagandës në favor të një organizate terroriste nuk kishin përmbyshur një nevojë të ngutshme shoqërore, nuk ishin proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura dhe si pasojë nuk ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike.

*** Bosnja dhe Hercegovina duhet të zbatojë vendime që urdhërojnë heqjen e kishës së ndërtuar në tokën e të mbijetuarve nga gjenocidi i Srebrenicës (01/10/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Orlović dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës** (*kërkesa nr. 16332/18*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, **njëzëri**, se kishte pasur: **shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një kishë të ndërtuar nga Famullia Ortodokse Serbe në tokën e parashtruesve pasi ata ishin detyruar të iknin nga prona e tyre gjatë luftës 1992-95. Gjykata konstatoi në veçanti se mosrespektimi nga ana e autoriteteve të vendimeve përfundimtare dhe detyruese të vitit 1999 dhe 2001 që urdhërojnë kthimin e tërësishëm të tokës nga parashtruesit e kërkesës, pa asnjë arsytim nga ana e Qeverisë për një mosveprim të tillë, kishte penguar seriozisht të drejtat e tyre pronësore.

Ajo gjithashtu konstatoi, me gjashtë vota me një, sipas **nenit 46 (Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve)** se Shteti i paditur duhej të

të siguronte zbatimin e dy vendimeve në favor të parashtruesve, duke përfshirë veçanërisht heqjen e kishës nga toka e parashtruesve, më së voni brenda tre muajve pasi ky aktgjykim të bëhej i formës së prerë.

*** Mohimi i Holokaustit nuk mbrohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (03/10/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Pastörs kundër Gjermanisë** (*kërkesa nr. 55225/14*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, **njëzëri**, se **ankesa e parashtruesit të kërkesës sipas nenit 10 (Liria e shprehjes) ishte qartazi e pabazuar dhe duhej të refuzohej, dhe, me katër vota me tri, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dënimin e një deputeti të *Landit* për mohimin e Holokaustit gjatë një fjalimi në Parlamentin rajonal. Gjykata konstatoi në veçanti që parashtruesi kishte deklaruar të pavërteta me dashje për të shpifur kundër Hebrenjve. Deklaratat e tilla nuk mund të tërhiqnin mbrojtjen e lirisë së fjalës të ofruar nga Konventat, ato ishin në kundërshtim me vlerat e vetë Konventës. Kështu që nuk ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës dhe ankesa ishte e papranueshme.

Gjykata gjithashtu shqyrtoi një ankesë nga parashtruesi i kërkesës për anshmëri gjyqësore pasi një nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit që kishte trajtuar rastin e tij ishte bashkëshorti i gjyqtarës të shkallës së parë. Ajo nuk gjeti shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë sepse një kolegji i pavarur i Gjykatës së Apelit pa asnjë lidhje me asnjë gjyqtar vendosi përfundimisht lidhur me padinë për anshmëri dhe e kishte refuzuar atë.

*** Mungesa e shërbimit civil si një alternativë për shërbimin ushtarak pengonte njohjen e kundërshtimit të ndërgjegjshëm, në kundërshtim me Konventën (17/10/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mushfig Mammadov dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit** (*kërkesa nr. 14604/08*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, **njëzëri**, se kishte pasur: **shkelje të nenit 9 (Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me refuzimin e parashtruesve të kërkesës për shkaqe fetare për të shërbyer në ushtri. Gjykata vërejti se ndjekjet penale dhe dënimet e parashtruesve për shkak të refuzimit të tyre për të kryer shërbimin ushtarak kishin rrjedhur nga fakti se nuk kishte një sistem alternativ të shërbimit, sipas të cilit individët mund të përfitonin nga statusi i kundërshtuesit të ndërgjegjshëm. Kjo përbënte ndërhyrje e cila nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Rasti theksoi një çështje që lidhej me mungesën e legjislacionit për shërbimin civil si një



alternativë për shërbimin ushtarak në Azerbajxhan. Nxjerrja e një ligji të tillë korrespondonte me një angazhim të ndërmarrë nga Azerbajxhani për pranimin e tij në Këshillin e Evropës dhe ishte gjithashtu një kërkesë sipas Kushtetutës së vetë vendit.

*** Arkëtarët spanjollë të supermarketeve të filmuar fshehurazi nga kamerat e sigurisë nuk pësuan shkelje të të drejtave të tyre të privatësisë (17/10/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në rastin **López Ribalda dhe të tjerët kundër Spanjës** (kërkesat nr. 1874/13 dhe 8567/13) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, **me 14 vota me tri**, se nuk ka pasur: **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe, **njëzëri** se nuk ka pasur **shkelje të nenit 6 paragraf 1 (E drejta për një proces të rregullt)**.

Rasti kishte të bënte me vëzhgimin e fshehtë të punonjësve që çoi në largimin e tyre.

Gjykata konstatoi në veçanti që gjykatat spanjolle kishin balancuar me kujdes të drejtat e parashtruesve - punonjësve të supermarketeve të dyshuar për vjedhje - dhe ato të punëdhënësit, dhe kishin kryer një ekzaminim të plotë të arsytimit për vëzhgimin me kamera. Një argument kryesor i paraqitur nga parashtruesit e kërkesës ishte se atyre nuk u ishte dhënë njoftimi paraprak për vëzhgim me kamerë, përkundër kërkesës së tillë ligjore, por Gjykata konstatoi se kishte pasur një arsyetim të qartë për një masë të tillë për shkak të një dyshimi të arsyeshëm për keqpërdorim serioz dhe të humbjeve të përfshira, duke marrë parasysh shkallën dhe pasojat e masës. Gjykatat vendase nuk e kishin tejkaluar fuqinë e tyre të diskrecionit ("liria e vlerësimit") në konstatimin se monitorimi ishte proporcional dhe legjitim.

*** Bosnja dhe Hercegovina duhet të ndryshojë legjislacionin që do të mundësonte mbajtjen e zgjedhjeve demokratike në Mostar (29/10/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Baralija kundër Bosnjë dhe Hercegovinës** (kërkesa nr. 30100/18) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vlerësoi, **njëzëri**, se kishte pasur: **shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 12 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një zbrazëti juridike e cila e bëri të pamundur që parashtruesi, një politikan vendas që jetonte në Mostar, të votonte ose të kandidonte në zgjedhje. Gjykata konstatoi se ajo zbrazëti juridike ishte krijuar nga dështimi i autoriteteve për të zbatuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2010 në lidhje me rregullimet për votim në zgjedhjet lokale në Mostar dhe për t'u thënë autoriteteve që të harmonizojnë legjislacionin përkatës me Kushtetutën. Kjo ishte kthyer në një situatë kur zgjedhjet e fundit

lokale në Mostar ishin mbajtur në vitin 2008 dhe qyteti ishte qeverisur që nga viti 2012 nga një kryetar i komunës i cili nuk kishte legjitimitetin e kërkuar demokratik. Një situatë e tillë ishte e papajtueshme me sundimin e ligjit. Prandaj Gjykata nuk mund të pranonte arsyetimin e Qeverisë për vonesën e zgjatur në zbatimin e aktvendimit, përkatësisht vështirësitë në krijimin e një mekanizmi afatgjatë dhe efektiv të ndarjes së pushtetit për këshillin e qytetit, në mënyrë që të ruajë paqen dhe të lehtësojë dialogun midis grupeve të ndryshme etnike në Mostar. Prandaj, Shteti nuk kishte përmbushur detyrën e saj për të marrë masa për të mbrojtur z. Baralija nga trajtimi diskriminues për shkak të vendbanimit të saj dhe për të mbajtur zgjedhje demokratike në Mostar. Ajo gjithashtu konstatoi, njëzëri, sipas **nenit 46 (Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve)** që Shteti duhej të ndryshonte legjislacionin përkatës, më së voni brenda gjashtë muajve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

*** Sistemi grek për lirimimin e nxënësve të shkollës nga orët e edukimit fetar shkel Konventën Evropiane (31/10/2019)**

Rasti **Papageorgiou dhe të tjerët kundër Greqisë** (kërkesat nr. 4762/18 dhe 6140/18) kishte të bëjë me arsimin e detyrueshëm fetar në shkollat greke. Në aktgjykimin e Dhomës së saj, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, **njëzëri**, se ekziston: **shkelje e nenit 2 të Protokollit Nr. 1 (E drejta për arsim)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, interpretuar në dritën e **nenit 9 (Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë)**.

Gjykata theksoi se autoritetet nuk kishin të drejtë të detyrojnë individët të zbulojnë bindjen e tyre. Sidoqoftë, sistemi aktual në Greqi për lirimimin e fëmijëve nga ora e edukimit fetar kërkonte që prindërit të paraqisnin një deklaratë solemne duke thënë se fëmijët e tyre nuk ishin të krishterë ortodoksë. Kjo kërkesë i vuri një barrë të panevojshme prindërve për të zbuluar informacionin nga i cili mund të nxirret se ata dhe fëmijët e tyre kishin, ose nuk kishin besim të veçantë fetar. Për më tepër, një sistem i tillë madje mund t'i pengojë prindërit të bëjnë një kërkesë për lirim, veçanërisht në një rast të tillë si rasti i parashtruesve, të cilët jetonin në ishuj të vegjël ku shumica e popullsisë i detyroheshin besnikërisë së një feje të veçantë dhe rreziku i stigmatizimit ishte shumë më i lartë.

*** Zvicra do të shkelte Konventën duke e kthyer në Afganistan një afgan të konvertuar në të krishterë (05/11/2019)**

Në Aktgjykimin e Dhomës në rastin **A.A. kundër Zvicrës** (kërkesa nr. 32218/17) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, **njëzëri**, se do të kishte: **shkelje të nenit 3** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rast të kthimit të parashtruesit të kërkesës në Afganistan. Rasti kishte të bënte me



largimin nga Zvicra në Afganistan të një shtetasi afgan të përkatësisë etnike Hazara, i cili ishte një mysliman i konvertuar në të krishterë. Gjykata vuri në dukje se sipas shumë dokumenteve ndërkombëtare për situatën në Afganistan, afganët që ishin bërë të krishterë ose që dyshohej për konvertim do të ekspozoheshin në rrezik të përndjekjes nga grupe të ndryshme. Kjo mund të marrë formën e persekutimit të shtetit dhe të rezultojë në dënim me vdekje.

Gjykata gjithashtu vlerësoi se, megjithëse vërtetësia e konvertimit të parashtruesit në Zvicër ishte pranuar nga Gjykata Federale Administrative, ajo nuk kishte kryer një vlerësim të mjaftueshëm të rreziqeve me të cilat parashtruesi mund të përballej personalisht nëse ai do të kthehej në Afganistan. Gjykata konstatoi në veçanti që dosja nuk përmbante asnjë provë që parashtruesi ishte pyetur për praktikën e përditshme të besimit të tij të krishterë që nga pagëzimi i tij në Zvicër dhe se si ai do të mundej, nëse kthehej, të vazhdonte ta praktikojë atë në Afganistan, në veçanti në Kabul, ku ai kurrë nuk kishte jetuar dhe ku tha se nuk do të ishte në gjendje të rindërtonte jetën e tij të ardhshme.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)



INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 784 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org